



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.22.1-2018-08

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR KOMUNËN E VITISË
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Vitisë, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe mendimi i dhënë është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit, *Svetlana Perovic* dhe anëtarëve, *Mehmet Kurti*, *Milos Petrovic* dhe *Agim Sogojeva*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Luljeta Morina*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm.....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Qeverisja e mirë	25
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve	28
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuar nga ZKA.....	35
Shtojca II: Letër e Konfirmimit.....	37

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Komunës së Vitisë për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 29/11/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Vitisë.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm


Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinionëve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-ve

Kryetari i Komunës së Vitisë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe është përgjegjës për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i vlerëson si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-në në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Ligjit për Financimin e Vetëqeverisjes Lokale nr. 05/ L - 108 dhe plotësimi nr. 03/ L - 049;
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr.01/2013 për Shpenzimin Parave Publike dhe Rregullën Financiare nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare;
- Kërkesat Ligjore për buxhetin e vitit 2018;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Planin e Prokurimit dhe Raportin për kontratat publike të nënshkruara;

-
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
 - Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë: raportet mujore dhe tremujore, raportet operative (të performancës);
 - Raportet tremujore për Kuvendin e Komunës dhe diskutimet rreth raporteve të NjAB dhe ZKA-së.

Kemi identifikuar disa gabime në shpalosjet në PFV-të siç janë:

- Neni 17, Raporti për detyrimet e papaguara, ka përfshirë detyrimet në shumë prej 11,419€, edhe pse ato ishin paguar, dhe në atë mënyrë ishte mbivlerësuar shuma e detyrimeve të përgjithshme;
- Nuk janë prezantuar dhe shpalosur drejta shpenzimet në vlerë prej 9,308€ sipas kategorive ekonomike për shkak të pagesave të vendimeve gjyqësore dhe të ekzekutuar direkt nga thesari.

DEKLARATA E BËRË NGA ZYRTARI KRYESOR ADMINISTRATIV

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm kemi identifikuar se Komuna ka përgatitur PFV-të në pajtim me kornizën raportuese, përveç që PFV-të nuk janë përgatitur në gjuhën serbe.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj se plani i përpilimit të PFV-së për vitin 2019 i adreson të gjitha çështjet të cilat janë cekur në lidhje me pajtueshmërinë e PFV-të, dhe është bërë analiza për përcaktimin e arsyeve për prezantimin jo të plotë të detyrimeve dhe klasifikimin e drejt të shpenzimeve në PFV-të dhe të sigurojë se janë vendosur proceset efektive për një shpalosje të drejt në të ardhmen.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Vitisë ka shpenzuar 95% të buxhetit final për vitin 2018, që nënkupton një realizim të mirë në përgjithësi. Në kontekstin e sistemeve financiare, kontrollet e të hyrave në përgjithësi janë të përshtatshme dhe zbatohen në mënyrë efikase, mirëpo, nevojiten mekanizma shtesë në mënyrë që të reagohet në mbledhjen e tyre dhe të arketueshmëve në shkallë më të lartë. Po ashtu, kontrollet për një serë të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtutjeshëm në mënyrë që të parandalohet kryerja e pagesave jo të rregullta.

Fushat kryesore ku ka nevojë për përmirësime të mëtutjeshme janë, menaxhimi i pagave, rrisin arkëtimin e të hyrave, përfshire edhe menaxhimin me pasurinë e komunës dhe arritjen e qëllimit për subvencionet e ndara.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	11,097,985	11,347,583	10,846,811	9,762,874	9,997,117
Granti i Qeverisë -Buxheti	9,938,211	9,865,065	9,844,173	8,877,644	8,903,175
Të bartura nga viti paraprak ² -		86,446	82,989	166,374	141,202
Të hyrat vetjake ³	1,047,005	1,047,005	689,683	688,538	781,569
Donacionet e brendshme		6,659	6,644	6,305	4,854
Donacionet e jashtme		223,993	220,224	24,013	166,317
Huamarrja	112,769	118,415	3,098		

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

² Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Dallimi ndërmjet buxhetit fillestar dhe final është 249,598€. Buxheti final, është rritur si rezultat i mjeteve të pashpenzuara, të bartura nga viti 2017, në shumë prej 86,446€, donacioneve të jashtme (Fondi i BE-së), në shumë prej 161,253€ dhe (Qeveria Zvicerane) në shumë prej 62,740€, Donacioneve të brendshme (pjesëmarrja e qytetarëve) në shumë prej 6,659€ dhe rritjes së huamarrjes nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në shumë prej 5,646€. Përveç rritjes, buxheti ka pësuar edhe zvogëlim nga Granti i Qeverisë për shkak të suficitit, në shumë prej 73,146€.

Në vitin 2018, komuna ka shpenzuar 96% të buxhetit final ose 10,846,811€. Në vazhdim, janë dhënë sqarimet për gjendjen aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	11,097,985	11,347,583	10,846,811	9,762,874	9,997,117
Pagat dhe Mëditjet	7,203,838	7,145,175	7,142,576	6,874,613	6,890,048
Mallrat dhe Shërbimet	1,281,874	1,316,406	1,063,318	941,906	974,180
Shërbimet komunale	200,862	200,862	198,832	200,580	200,287
Subvencionet dhe Transferet	197,712	274,582	260,486	272,706	163,003
Investimet Kapitale	2,213,699	2,410,558	2,181,599	1,473,069	1,769,599

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikimin që kanë pasur:

- Buxheti fillestar për kategorinë paga dhe mëditje, për shkak të suficitit, kishte zvogëlim prej 73,143€ me Vendim të Qeverisë, ndërsa kishte rritje të donacioneve në shumë të përgjithshme prej 12,980€ dhe të hyrat vetjake të bartura që nga viti 2016, ishin në shumë prej 1,500€. Shpenzimi i buxhetit në kategorinë e pagave ishte rritur në raport me vitin e kaluar për 4%, pas rritjes së pagave në nivelin qendror. Pjesa e shpenzimeve për kategorinë e pagave përbën 66% nga shpenzimet e përgjithshme të komunës, përveç së cilave komuna ka edhe shpenzime të konsiderueshme në emër të Kontratave për punë të veçanta (shih: realizimi i buxhetit për këtë kategori është 100%, nga të cilat shuma e përgjithshme e donacioneve ishte harxhuar për kategorinë e pagave në shumë prej 11,883€);
- Buxheti fillestar për mallra dhe shërbime ishte 1,281,874€, nga Granti i Qeverisë ishte në shumë prej 922,119€ dhe nga të hyrat vetjake të planifikuara, prej 246,986€, si dhe nga huamarrja shuma prej 112,769€. Buxheti përfundimtar për këtë kategori ishte rritur për 34,532€, dhe atë nga donacionet, në shumë prej 15,540€, nga mjetet e pa shpenzuara vetjake, të bartura nga viti 2017, në shumë prej 15,178€, nga rritja e huamarrjes prej MASHT-it, në shumë prej 3,388€ dhe nga donacionet e pashpenzuara të bartura, në vlerë prej 426€. Shpenzimet e përgjithshme për këtë kategori ishin në vlerë prej 1,063,318€ apo 81%, ndërsa pjesa e mbetur ka mbetur i parealizuar për shkak të planifikimit të shpenzimeve nga të hyrat, të cilat komuna nuk kishte arritur që ti mbledh nga shuma e planifikuar;

-
- Buxheti për shpenzimet komunale ishte në vlerë prej 200,862€ nga Fondi i Grantit Qeveritar. Shpenzimet ishin në nivel prej 99%;
 - Buxheti për subvencione dhe transfere ishte rritur për 76,870€ nga të hyrat vetjake, të bartura nga viti i kaluar në shumë prej 324€, donacionet e brendshme (participimi i qytetarëve) në vlerë prej 6,659€, donacionet e jashtme (Fondi i BE) në vlerë prej 64,699€ dhe donacioni i Qeverisë Zvicerane në shumë prej 5,188€. Realizimi i kësaj kategorie të shpenzimeve ishte në nivelin prej 95%; dhe
 - Buxheti përfundimtar për investime kapitale ishte në vlerë prej 2,410,558€, për 196,859€ më tepër në raport me buxhetin fillestar, si rezultat i të hyrave vetjake nga viti 2017, në shumë prej 69,443€, donacioneve (Fondi i BE-së) në shumë prej 73,049€, nga donacionet e Qeverisë Zvicerane në shumë prej 52,108€, huamarrjes nga MASHT-i në shumë prej 2,258€ dhe donacioneve të brendshme 1€. Realizimi i buxhetit është rritur në raport me vitin e kaluar për 10% (në vitin 2017, realizimi ishte në nivelin prej 81%), nga të cilat një pjesë kishte mbetur e përealizuar për shkak të planifikimit të shpenzimeve nga të hyrat, të cilat komuna nuk ka arritur ti mbledh nga shuma e planifikuar. Pjesëmarrja e investime kapitale në shpenzimet e përgjithshme është 20%, nga të cilat nga Granti i Qeverisë për projekte kapitale ishte shpenzuar shuma prej 1,598,811€, ndërsa pjesëmarrja nga të hyrat vetjake ishte në shumë prej 455,381€.

Gjatë vitit 2018, në Komunën e Vitisë kishte vazhduar me realizimin e projekteve të kontraktuara gjatë 2017 (investimet në proces), të cilit janë financuar nga ana e Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Rekomandimet

Çështja B1 - Keq-klasifikim i shpenzimeve si rezultat i pagesave të drejtpërdrejta nga Thesari

Gjetja Në bazë të Vendimit të Gjykatës gjatë vitit 2018, janë kryer pagesat në vlerë prej 98,400€ nga të cilat 97,429€ janë kryer drejtpërdrejtë nga Thesari, ndërsa Komuna ka kryer pagesën në vlerë prej 971€.

Nga shuma e cekur, pagesat për paga dhe shujta në vlerë prej 9,308€ të ekzekutuara nga thesari ishin klasifikuara gabimisht nga kategoria për mallra dhe shërbime në shumë prej 6,024€, dhe pagesa për shpenzime (shpenzime gjyqësore, interesi dhe dënime) në shumë prej 3,284€ nga kategoria e investimeve kapitale.

Si rezultat i ekzekutimit të pagesave në bazë të vendimeve gjyqësore, ankuesve u është paguar shuma prej 90,775€, ndërsa për shpenzimet e procedurësishte paguar shuma prej 7,625€.

Rreziku Klasifikimi jo i rregullt i shpenzimeve, sjell deri tek paraqitja jo e rregullt e shpenzimeve në Pasqyrat Financiare, në këtë rast mbivlerësim të shpenzimeve të kategorisë mallra dhe shërbime dhe nënvlerësim të shpenzimeve në kategorinë paga dhe mëditje.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë përgjegjësi më të madhe në kryerjen e detyrimeve me kohë ndaj operatorëve, si dhe që gjatë planifikimit të buxhetit duhet ta bëjë vlerësimin e shumave të mundshme të rrjedhës së parasë së gatshme nga kontestet gjyqësore dhe që ato të paguhen në kuadër të buxhetit vjetor, në mënyrë që të shmanget paraqitja e gabuar dhe të mos rrezikohet zbatimi i shpenzimeve tjera të planifikuara.

3.1.1 Të hyrat

Komuna gjatë vitit 2018, ka mbledhur të hyra direkte në vlerë prej 694,570€ apo 82% nga shuma e planifikuar (846,630€), ndërsa mbledhja e të hyrave indirekte (nga dënimet policore, gjyqësore dhe pyjore) ishte në vlerë prej 98,421€ apo 49% nga shuma e planifikuar (200,375€). Nga tabela mëposhtë shohim se të hyrat e planifikuara në kuadër të buxhetit fillestar janë në vlerë prej 1,047,005€, përfshirë edhe planin e mbledhjes të hyrave indirekte.

Të hyrat e realizuara nga tatimi në pronë janë në vlerë prej 329,525€ apo 82%, nga shuma e planifikuar (400,000€) dhe kanë një trend të rritjes në raport me vitin 2017 kur të hyrat nga Tatimi në pronë ishin 292,115€. Mirëpo, të hyrat mbesin në nivel të ulët të realizimit (69%) në raport me vlerën e faturuar të tatimit në pronë, e cila për vitin 2018 është në vlerë prej 476,264€ (përfshirë interesin dhe dënimet).

Një pjesë e konsiderueshme e të hyrave vjen nga taksa e regjistrimit të veturave (91,720€) dhe ato shënojnë tejkalim të shumës së planifikuar (79,500€) për 15%. Kompensimet nga lejet ndërtime, taksat administrative dhe të hyrat tjera janë në vlerë prej 365,045€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti përfundimtar	2018 realizimi	2017 realizimi	2016 realizimi
Të hyrat vetjake	1,047,005	1,047,005	694,570	707,076	786,812

Nga shuma e përgjithshme e të hyrave të mbledhura në vitin 2018 Komuna kishte shpenzuar 689,683€. Të hyrat nga viti 2017 dhe viteve të kaluara, në vitin 2018 i kishte bartur në shumë prej 86,446€, nga të cilat i kishte shpenzuar në vlerë prej 82,989€.

Të hyrat vetjake nga viti 2017 dhe 2018, të cilat do të barten në vitin 2019 janë në vlerë prej 105,765€.

Rekomandimet

Çështja B2 - Dhënia me qira e pronës komunale pa iu nënshtruar procedurave të duhura

Gjetja Sipas ligjit Nr. 04/L - 144 për dhënien në shfrytëzim dhe shkëmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Kryetari i Komunës i Propozon Kuvendit të Komunës (MA) që ta lejojë pronën e paluajtshme për ta shfrytëzuar, dhe pas dhënies së pëlqimit nga Kuvendi i Komunës, ajo e themelon Komisionin i cili i vlerëson ofertat përmes ankandit publik. Nga tri kontratat e lidhura gjatë vitit, në një rastet Komuna nuk iu është përmbajtur këtyre kërkesave ligjore, gjatë dhënies së pronës komunale me qira, përkatësisht, nuk ka zbatuar procedurën e ankandit.

Rreziku Dështimi për të zbatuar procedurat në pajtim me kërkesat ligjore, sjell deri te dhënia e kundërligjshme e pronës së paluajtshme në shfrytëzim dhe, si rezultat i kësaj, menaxhimi i pronës nuk është kryer në mënyrë të rregullt.

Rekomandimi B2 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se dhënia e pronës komunale në shfrytëzim të kryhet sipas procedurave të parapara ligjore dhe vendimeve të Kuvendit Komunal.

Çështja A2 - Mangësi në vendimin për shfrytëzimin e pronave

Gjetja Rregullorja e brendshme për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha, në nenin 12, pika 12.1.3, thekson se çmimi për shfrytëzimin e hapësirave publike për lokale është 2€/m²/në muaj. Drejtoria për Shërbime publike dhe Emergjencia, ka marrë Vendime në tetë (8) raste për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm të hapësirave publike në të cilat nuk specifikohet periudha e as çmimi për muaj. Kjo për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve dhe mungesa e kompetencës së stafit përgjegjës.

Rreziku Mos specifikimi i periudhës rrezikon që taksa mos të paguhet për periudhën e plotë kohore, si dhe që përlllogaritja e saj të mos jetë e saktë, gjë që rrezikon mbledhje më të ulët të të hyrave.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë një kontroll më të lart në Drejtorinë për Shërbime Publike, në mënyrë që Rregullorja e brendshme për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha të zbatohet në tërësi dhe vendimet të jen të qarta dhe të sakta.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF, të cilat nuk janë të integruara me bazën e të dhënave të personelit, por megjithatë ofron kontroll efikas dhe sistem të pagesës i cili i përshtatet nivelit të komunës. Kontrollat e bëra nga ana e komunës kanë të bëjnë me përlllogaritjen e pagave në pajtim me kontratat e të punësuarve dhe me ligjet në fuqi. Komuna i përditëson pagat në bazë mujore, para kryerjes së listës së pagave, ndërsa ndryshimet janë bërë me kohë.

Kemi testuar procedurat e punësimit, dosjet e personelit, kemi kontrolluar listat e pagave dhe i kemi krahasuar informatat e paraqitura në SIMFK dhe prezantimin e tyre në PFV-të.

Rekomandimet

Çështja A3 - Koeficiente të gabuara për përlllogaritjen e pagave në arsim

Gjetja Bazuar në Ligjin e Punës Nr.03/L-212, Ligji për pagat e shërbyesve publik, dheme tri Vendimet e Qeverisë të datave 2011, 2014 dhe 2018 përcaktohet baza për përlllogaritjen e pagave për stafin e arsimit. Kemi gjetur se në Drejtorinë e Arsimit, janë punësuar tri (3) mësuese (në vitin 2018) si zëvendësim të lehonave dhe kanë pranuar paga të përlllogaritura sipas koeficientit të gabuar A - 382, i cili deri në vitin 2011 ishte në përdorim kryesisht për mësuesit e Arsimit Fillor, ndërsa nga viti 2011 ai nuk zbatohet më.

Me analizë të detajuar u vërtetua se për shkak të përlllogaritjes së gabuar, komuna për dy zyrtare kishte paguar shumë të zvogëluar të pagave për 108€. Shkak i këtij problemi ishte kontrolli jo adekuat i brendshëm dhe reagim jo në kohë për parregullsitë krijuara.

Rreziku

Për shkak të kontrollit jo adekuat të brendshëm, komuna në të ardhmen mund të ballafaqohet me parregullsi të ngjashme me rëndësi materiale më të madhe, e cila do të mund të sillte konteste gjyqësore dhe shpenzime të panevojshme për komunën.

Rekomandimi A3 Komuna duhet të bëjë pagesën retroaktive për kompensimin e shumave të paguara më pak, për dy zyrtaret e cekura, si dhe me forcimin e masave të kontrollit të brendshëm ta parandalojë përsëritjen e lëshimeve të ngjashme në të ardhmen.

Çështja A 4 - Parregullsi në shkolla për aftësimin profesional

Me auditimin e Shkollës për Aftësim Profesional të rriturve, u identifikuan parregullsitë, si në vijim:

- Menaxhmenti i Komunës me vetiniciative kishte marrë Vendim për formimin e Shkollës për Aftësimin profesional të rriturve, pa pëlqim me shkrim, përkatësisht Vendimit nga MASHT. Kjo ishte në kundërshtim me Ligji nr.04/L-143 për Aftësimin Profesional të Rriturve, si dhe nenin 2 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, 08/2015 për Formimin e Institucioneve Arsimore;
- Po ashtu, për planin dhe programin e zbatuar nuk është marrë pëlqimi i MASHT-it, me çka është shkelur Udhëzimi Administrativ nr. 13/ 2014, për Planin vjetor të punës dhe plani zhvillimor i ofruesve për të arsimit formal të të rriturve. Kjo ka sjellë që në Ditarin shkollor të shënohen deri në tridhjetë orë të mbajtura në ditë, në një klasë;
- Komuna nuk e ka respektuar Udhëzimin Administrativ të MASH-it nr. 05/2014 për Agjencinë Qeveritare për Aftësimin Profesional të Rriturve, e as Ligjin nr.04/L-138 neni 13 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, për administrim dhe udhëheqje të institucioneve të arsimit dhe aftësimin profesional. Pra kjo shkollë nuk është menaxhuar/ mbikëqyrur nga Agjencioni Qeveritar në lidhje me udhëheqjen, por edhe në kuptimin administrativ dhe pedagogjik; dhe
- Përzgjedhja dhe pagesa e personelit të arsimtarëve dhe stafit ndihmës nuk është rregulluar me asnjë Rregullore/ Rregullore të Brendshme Drejtori i shkollës në mënyrë të pavarur e bënë përzgjedhjen e kuadrit arsimor dhe teknik dhe merr vendime për lartësinë e kompensimit për të punësuarit. Të punësuarit nuk kanë kontrata për punë shtesë. Ata punojnë dhe paguhen në bazë të kontratës të cilën e posedojnë për punët primare në shkolla të rregullta. Zyrtaret nuk kanë mundur ta arsyetojnë, anashkalimin e këtyre proceduarve.

Rreziku Për shkak të këtyre parregullsive, komuna mund të ballafaqohet me organet e drejtësisë, për shkak se themelimi dhe funksionimi i kësaj shkolle nuk përputhet me rregullat në fuqi.

Rekomandimi A4 Kryetari i Komunës duhet që ti përcaktojë përgjegjësitë e atyre të cilët me veprime të veta kanë sjellë komunën në këtë gjendje të pafavorshme, dhe të ndërmerr masat e përshtatshme në pajtim me ligjin. Të forcojë kontrollet e brendshme, në mënyrë që në të ardhmen të gjitha aktivitetet në lidhje me organizimin, funksionimin dhe financimin e shkollës për të rriturit të përshtaten në plotësi me Ligjet dhe Udhëzimet Administrative të MASHT-it.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2018 ishte 1,316,406€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,063,318€. Këto shpenzime kanë të bëjnë me shërbimet kontraktuale, mirëmbajtja e rregullt, derivate, dreka, ushqim etj. Shpenzimet për shërbimet komunali ishin 198,832€.

Rekomandimet

Çështja B3 – Marrëveshjet për shërbime të veçanta pa procedura

Gjetja Sipas Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës, me rastin e aplikimit të marrëveshjeve për shërbime të veçanta zbatohet procedura e thjeshtëzuar e punësimit. Edhe gjatë vitit 2018, komuna ka vazhduar të angazhojë të punësuar në bazë të marrëveshjes për shërbime të veçanta. Në komunë ishin angazhuar gjithsej 53 të punësuar përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta, ndërsa shuma e paguar për këto shërbime gjatë vitit ishte 53,218€, përfshirë pagesat edhe sipas kontratave nga viti 2017. Kemi vërejtur se nga 53 të punësuar të cilit ishin angazhuar sipas marrëveshjeve për shërbime të veçanta, 42 nga ta ishin të angazhuar pa procedura të punësimit. Pozitat në të cilat ishin bërë ato punë kanë të bëjnë kryesisht në Njësinë e Tatimit në Pronë, Shërbimin për Regjistrim, Shërbimin Zjarrfikës dhe Pedagogë në Shkolla. Si arsytim për angazhimin në këtë mënyrë ishte sepse Ministria e Financave nuk e kishte lejuar rritjen e numrit të personelit.

Rreziku Ikja nga procedura e punësimit gjatë lidhjes së kontratës për kushte të veçanta mund të sjellë deri te kyçja e personave joadekuat për kryerjen e shërbimeve të nevojshme, e cila gjë mund të sjellë deri te mos efektiviteti operativ dhe moskryerja e objektivave të organizatës. Kjo po ashtu nuk ofron trajtim të barabartë për të gjithë konkurrentët potencial.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të siguroj se marrëveshjet për shërbime të veçanta të lidhen pas zbatimit të procedurave të thjeshtëzuara të punësimit, përmes konkursit publik dhe vetëm në rastet e kërkesave specifike për punë, dhe jo për pozita të rregullta.

Çështja A5 - Vonesa në nënshkrimin e deklaratës në betim

Gjetja Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e ofertave duhet të japin deklaratë nën betim e cila duhet të jetë e nënshkruar në momentin e fillimit të punës (vlerësimin), apo më së voni 5 ditë pas hapjes së ofertave, siç përcaktohet me nenin 41.2 të Rregullores për udhëzimet operative për prokurim publik. Në tri⁴ raste, anëtarët e Komisionit për vlerësim të tenderit kanë nënshkruar Deklaratën nën Betim me vonesë. Kjo reflekton në kontrolle jo funksional të vendosura nga komuna.

Rizik Anashkalimi i proceduarve mund të rezultojë me komisione jo valide apo vonesa në vlerësimin e ofertave.

Rekomandimi A5 Kryetarit të sigurohet se kontrollet e vendosura janë duke funksionuar dhe dëshmitë për funksionin të këtyre kontrolleve të plotësohen sipas afateve të parapara me rregulla.

Çështja A6 - Mangësi në procesimin e pagesave

Rreziku Komuna ka kryer tri (3) pagesa në vlerë të përgjithshme prej 18,084€, duke pranuar dhe paguar fatura para se të behët zotimi mjeteve. Për me tepër tek rasti i “furnizimi me material të shtypur, material reklamues etj” kontrata është lidhur me 20.03.2018, fatura dhe pranimi i malli në depo me datë 21.03.2018 ndërsa zotimi i mjeteve apo kërkesa zotimi për blerje është e mëvonshme apo 13.04.18, urdhër blerja me 18.04.2018 dhe raporti i pranimit 19.04.2018. Kjo për shkak të mangësive në planifikimin e shpenzimeve dhe kontrolleve jo funksionale në kontraktimin pa zotim të mjeteve.

Rreziku Mungesa mjeteve të nevojshme ka reflektuar në vonesa për pagesën me kohë të faturave e cila ka mundësi të rritë obligimet /detyrimeve e ndërmarra nga komuna. Vonesat mund edhe të vendosnin komunën para institucione të drejtësisë dhe përpalljen me shpenzime shtesë.

Rekomandimi A6 Kryeri duhet të sigurohet se furnizimit i paraprin urdhëresa për blerje e cila është e mbuluar me zotim të mjaftueshme të mjeteve, apo mjetet duhet të sigurohen para se të hyhet në obligime kontraktuale.

⁴ Kontrata “Dërgimi i druve për ngrohje për të gjitha njësitë shpenzuese”, në vlerë prej 135,778,50€; “Furnizimi me artikuj” në vlerë prej 27,534€, “Dërgimi i materialit të printuar dhe për promocion” në vlerë prej 27,402€.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Komunës së Vitisë në vitin 2018, për Kategorinë Subvencionet dhe Transferet me buxhet i ish in lejuar 274,582€, nga kjo shumë ish in shpenzuar 260,486€, pra 95% e buxhetit. Komuna në vitin 2018 kryesisht i kishte subvencionuar Shoqëritë sportive, OJQ-të, Bujqësinë si dhe ndihmën sociale për persona fizik.

Nga kjo kategori kemi testuar pagesa dhe kemi kontrolluar nëse janë kryer në pajtim me Rregulloren për ndarjen e subvencioneve.

Rekomandimet

Çështja C1 - Mosrespektimi i Rregullores së brendshme dhe Ligjit në fuqi

Gjetja Kriteret bazë në të cilat auditimi i këtij problemi do të bazohet kanë të bëjnë me Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, si dhe në Rregulloren e brendshme për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Vitisë.

Komuna herën e parë me 27.02.2018, në vlerë prej 10,000€ dhe herën e dytë me 18.05.2018, në vlerë prej 5,000€ i kishte dhënë subvencion “KF Vllaznia” nga Pozharani, dhe në të dyja rastet nuk e ka respektuar Rregulloren e brendshme për ndarjen e subvencioneve. Kryetari nuk e ka emëruar Komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave, me çka është shkelur neni 7 i Rregullores së brendshme; shfrytëzuesi i subvencionit nuk e ka ofruar dokumentacionin e nevojshëm në aplikacionin e tij, me çka nuk është respektuar neni 22, pika 3 e Rregullores (në dokumentacionin e ofruar ekziston vetëm vendimi për ndarje), dhe në fund nuk ka raportim nga ana e shfrytëzuesit të subvencionit, me çka është shkelur pika 2 e Vendimit në bazë të cilit është ndarë subvencioni.

Shkaku i këtij problemi qëndron në faktin se menaxhmenti nuk i ka përfillur rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm nga viti i kaluar, prandaj në vitin 2018 e ka përsëritur gabimin e njëjtë. Pra kjo situatë vazhdon të përsëritet për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të vendosura me rregulla.

Rreziku Komuna e Vitisë, për shkak të mosrespektimit të dispozitave të Rregullores së brendshme e krijon mundësinë për keqpërdorim të parasë publike, si dhe mundësinë që subvencionet e ndara të mos e arrijnë qëllimin e tyre.

Rekomandimi C1 Kryetari i komunës duhet të sigurojë të gjitha masat në mënyrë që ta forcojë kontrollin e brendshëm të tërë procesit të ndarjes së subvencioneve, duke filluar nga Thirrja Publike, përmes respektimit të Rregullores gjatë aplikimit, emërimit dhe punës së Komisionit, e deri te raportimi, e gjithë kjo me qëllim që subvencionet e ndara ta arrijnë qëllimin e tyre.

Çështja A7 – Mosrespektim i marrëveshjes dhe pagesa të parregullta**Gjetja**

Me rastin e ndarjes së subvencioneve komuna duhet të bazohet në Ligjin nr. 03/L-048 për menaxhimin dhe përgjegjësitë për punë në financa publike, si dhe Rregullorja e brendshme për ndarjen e subvencioneve të Komunës së Vitisë.

Komuna e Vitisë ka nënshkruar një marrëveshje me organizatën zvicerane Helvetas për shpërndarjen e pajisjeve për fermerët. Vlera e kontratës është në shumën totale prej 34,184€ (50 copë makina për shpërndarje të plehut, 114 bidon për qumësht, 50 rezervuar uji 1,000 litra, 30 mot kultivator, etj.). Shuma e përgjithshme e buxhetit komunal për këtë projekt është 16,532€, pjesëmarrja e fermerëve është 7,266 € dhe Helvetas ka një pjesë prej 10,386€.

Komuna nuk ka zbatuar procedurën e tenderit në pajtim me specifikimet në marrëveshje, në kuptim të sasisë dhe llojit të aktivitetit. Komuna e ka ndarë tenderin në dy procedura duke nënshkruar dy kontrata me dy OE. Në kuadër të kontratës së parë, janë përcaktuar tre aktivitete (shpërndarëset e plehut, bidona për qumësht dhe rezervuarë uji) në shumën totale prej 16,596€, që përfaqëson buxhetin e përgjithshëm komunal për tërë projektin.

Pastaj ka nënshkruar një kontratë tjetër në vlerë prej 4,158€ për ekzekutimin e një aktiviteti (blerja e 22 moto kultivator). Komuna ka paguar një shumë prej 2,079€ për kontratën.

Kjo marrëveshje nuk u respektua as me sasi e as me vlerë, por me një aneks ishte ndryshuar në përfundim të procesit, përkatësisht pak para kryerjes së pagesës.

Komuna sipas kontratës së parë i kishte paguar furnizuesit shumën prej 6,842€ nga të hyrat vetjake, ndërsa shumën prej 4,149€ nga participimi i qytetarëve, derisa organizata Helvetas kishte paguar 4,149€. Edhe pse participimi i shfrytëzuesve për këtë projekt ishin saktësisht 4,149€, komuna nuk i ka përdorur në tërësi këto mjete për pagesën e furnitorit për furnizimin e kryer, por ka përdorur mjetet e ndara të destinuara të projektit tjetër (nga viti 2017, në vlerë prej 1,456€) pra janë shfrytëzuar vetëm 2,693€ parat / participimi i destinuar për këtë projekt, tjerat janë bartur për vitin e ardhshëm. Për shkak të menaxhimit të dobët me financa, përkatësisht, mosrespektimit të marrëveshjeve, ndodh që mjetet e destinuara për të cilën kanë participuar qytetaret mos të jenë shpenzuar në pajtim me qëllimin e tyre.

Rreziku Mosrespektimi i marrëveshjes dhe menaxhimi i dobët me financa, përkatësisht shpenzimi i mjeteve të destinuara për qëllime tjera, mund të krijojë për komunën borxhe të panevojshme, madje edhe procedura gjyqësore.

Rekomandimi A7 Kryetarin e Komunës duhet të vërtetojë arsyet për mosrespektimin e marrëveshjeve të arritura, si dhe mos shpenzimin e mjeteve të destinuara për qëllime për të cilat ishin mbledhur nga participimi i qytetareve, dhe ta forcojë kontrollin e brendshëm në këtë fushë, në mënyrë që kjo të mos ndodhë në të ardhmen.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale është 2,410,558€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 2,181,599€. Këto shpenzime kanë të bëjnë me pagesat e vendimeve gjyqësore, ndërtimit të rrugëve lokale, kanalizimeve, objekteve të arsimit dhe mobilie.

Rekomandimet

Çështja B4 - Mungesa e lejeve të ndërtimit, mbikëqyrjes inspektive dhe lejes së përdorimit

Gjetja Sipas Ligjit të ndërtimit, me rastin e kontratave ndërtimore kërkohet pajisja me dokumentacionin përkatës siç është leja ndërtimore, mbikëqyrja inspektive si dhe leja e përdorimit. Komuna në tri (3)⁵ raste nuk kishte aplikuar lejet ndërtimore apo mbikëqyrjen inspektive. Gjithashtu, kemi identifikuar se komuna nuk lëshon leje përdorimit ende për as një objekt të përfunduar.

Rreziku Inicimi i projekteve në mungesë të kompletimit të dokumentacionit sipas kërkesave të ligjit për ndërtim, mund të ndikojë në cilësinë dhe ngecjen në realizimin e këtyre projekteve.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të siguroj se projektet janë pajisur me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kërkesat e Ligjit të ndërtimit, me ç' rast fillimisht sigurohet leja ndërtimore, mbikëqyrja inspektive gjatë ekzekutimit dhe në fund të projektit edhe leja e përdorimit.

⁵ "Rregullimi i rrethojave shkollore" "Ndërtimi urës Letnicë" dhe "Rregullimi hapësirave gjelbëruese publike në K. Vitisë".

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Ne kemi testuar gjendjen fillestare, blerjen e pasurisë gjatë vitit, përfshirë edhe investimet kapitale, si dhe blerjet për pajisje dhe mobile, në vlerë nën 1,000€ nga mallrat dhe shërbimet, si dhe rregullsinë e evidentimit të pasurisë e cila është në dispozicion. Kemi kryer po ashtu edhe kontrollin fizik në mënyrë që të vërtetonim ekzistimin e pasurisë.

Komuna ka menaxhuar me pasuritë në mënyrë të duhur, mirëpo, çështjet e identifikuara në pasqyrat nga vitet e kaluara janë përsëritur edhe këtë vit.

Rekomandimet

Çështja B5 - Dobësi në regjistrimin dhe menaxhimin me pasuritë

Gjetja Pavarësisht nga rekomandimet e dhëna në vitet e kaluara, çështjet që ndërlidhen me pronën bazuar në Rregullën Financiare nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare, ende janë sfidë për komunën:

Katër shkollat të cilat i financon MASHT-i, të cilat komuna i shfrytëzon nga viti 2012, ishin të regjistruara në regjistrin e pasurisë në mungesë të dokumentacionit përcjellës, vetëm përmes e-mailave të dërguar nga ana e zyrtarit të MASHT-it. Edhe përkundër kërkesës së zyrtarit për pasuri për ofrimin e këtij dokumentacioni, MASHT-i ende nuk është përgjigjur pozitivisht dhe komunës nuk i janë dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm për bartjen e pronësisë; dhe

Inventari të cilin MAPL e kishte blerë në vitin 2012, në vlerë prej 30,000€, nuk ishte i përfshirë në regjistrat e pasurisë edhe pse ishte vendosur në depot e objektit të ri të komunës. Kjo kishte ndodhur për shkak se zyrtari i parimit nuk ishte i njoftuar për pasurinë e pranuar nga komisioni, dhe pasuria ende nuk është regjistruar në regjistrin E-pasurisë, edhe pas rekomandimit tonë nga vitet e kaluara.

Rreziku Mungesa e dokumentacionit për pasurinë e regjistruar, të cilën e shfrytëzon komuna, rezulton me pasiguri për pronësinë mbi këto pasuri. Marrë parasysh mos regjistrimi dhe mbajtja në depo e pasurisë për kohë të gjatë si e pa shfrytëzuar, rrezikon që të shkatërrohen apo keqpërdoren këto pasuri.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të menaxhimit të pasurisë, në këtë rast, në mënyrë që të sigurohet se po ndërmerren hapat konkret për ofrimin e dokumentacionit burimor nga MASHT-i dhe regjistrimit të pasurisë të financuara nga ana e MAPL-ja, në regjistrat e pasurisë së komunës.

3.3 Të arkëtueshmet

Të arkëtueshmet në fund të vitit 2018 tregojnë një trend të rritjes së këtyre llogarive, pasi që Komuna kishte shfaqur të arkëtueshmet në vlerë prej 2,012,213€, në krahasim me 1,921,000€ sa ishin në vitin e kaluar. Kjo po ndodh për shkak të politikave jo efektive, të cilat janë zbatuar nga ana e menaxhmentit dhe për shkak të mungesës së strategjisë për pagesën e këtyre borxheve. Këto të arkëtueshme janë nga: Tatimi në pronë, në shumë prej 1,669,248€, taksat nga bizneset, në shumë prej 315,157€ (të arkëtueshmet datojnë nga vitet e kaluara ndërsa me Vendim të Kuvendit Komunal të njëjtat më nuk paguhen); qiradhënia e hapësirat publike, në vlerë prej 19,000€, që datojnë nga viti 2017.

Sistemi i regjistrimit të taksapaguesve është i centralizuar në bazë të dhënave të tatimit në pronë e cila përbën informatat për të gjitha komunat në Kosovë, dhe mbahet nda Departamenti për tatimin në pronë pranë Ministrisë së Financave (MF). Secila komunë është e obliguar që ta kryejë verifikimin, përkatësisht ta menaxhojë vendosjen e informatave të tatimit në pronë në kuadër të bazës së të dhënave, me të gjitha informatat, përfshirë edhe tatimin në pronë, adresat e pronave, adresat e pronarëve dhe përdoruesve, të thënat për tokat dhe objektet, vlerat e pronës, shkallën e tatimit, detyrimet tatimore, si dhe evidencat e pagesave të tatimeve.

Rekomandimet

Çështja C2 - Menaxhim jo i mirë i llogarive e të arkëtueshmeve

Të Arkëtueshmet nga tatimi në pronë menaxhohen dobët. Në regjistrin e taksapaguesve ekzistojnë borxhlinj të tatimit (292 borxhlinj), borxhi i të cilëve është në vlerë prej 1,000€ deri në 37,103€, ku detyrimi i përgjithshëm kap vlerën 665,923€, përkatësisht mbi 40% të arkëtueshmëve të përgjithshme.

Komuna nuk ka ndërmarrë masat efektive për pagesën e të arkëtueshmëve, duke bërë që këto të jenë në rritje në raport me vitin e kaluar. Kjo është pasojë e mos zbatimit të mekanizmave të komunës për rritjen e arkëtimit të të hyrave.

Rreziku

Rritja e llogarive të arkëtueshme dhe pamundësia për ti mbledhur me kohë rezulton me menaxhim jo efektiv të tyre për shkak të pamundësisë së komunës për ndërmarrjen e masave adekuate për arkëtimin e tyre. Mungesa e masave konkrete për mbledhjen e Ll/A, ndikon në moskryerjen e shpenzimeve të planifikuara nga të hyrat.

Rekomandimi C2 Kryetari duhet ta fillojë procesin e rishqyrtimit, ku do të analizoheshin të gjitha llogaritë, në kuptimin e vjetërsisë, shumave të rëndësishme, mundësive reale për pagesë dhe zbatimit të masave ligjore për mbledhjen e tyre.

3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte në vlerë prej 214,778€, gjë që paraqet një trend të rënies, marrë parasysh që në fund të vitit 2017, vlera e obligimeve ishte në shumë prej 232,000€. Komuna ka evidentuar detyrimet kontingjente në vlerë prej 407,000€.

Zvogëlimi direkt i detyrimeve bëhet në bazë të harmonizimit të detyrueshëm, jashtë harmonizimit gjyqësor, vendimit përfundimtar të Gjykatës si dhe me rastet tjera për të cilat ekziston dokumentacioni i vlefshëm me të cilat mund të vërtetohet që obligimet e bëra nuk do të paguhen në afat prej 60 ditëve nga dita kur ishte dashur të paguhen. (Lidhur me këtë çështje, në veçanti kemi diskutuar në çështjen A1).

Rekomandimet

Çështja A8 - Raportimi i gabuar dhe evidentimi joadekuat i detyrimeve

Gjetja Sipas Rregullën Financiare nr.02/2013 për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore neni 5: Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që në Ministrinë e Financave - Thesar të raportojnë obligimet e tyre të papaguara. Përmes procedurave të auditimit kemi gjetur që shumica e shpalosur në PFV për 2018 nuk jep pasqyrë të drejtë të obligimeve, për shkak të vazhdim:

- Detyrimi ndaj një furnitori, në vlerë prej 4,035€ u paraqit në raportin financiar si detyrim i papaguar dhe si detyrim kontingjent;
- Obligimi kundrejt furnitorit në vlerë prej 9,087€, është paguar në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të faturës, ndërsa nuk do të duhej të paraqitej në raportin për MF në lidhje me pagesat e pakryera; dhe
- Obligimi ndaj një furnitori, në vlerë të përgjithshme prej 7,384€, ishte paguar në dhjetor të vitit 2016, ndërsa gjendet në PFV për 2018.

Menaxhmenti i komunës nuk mbante evidencën adekuate për faturat e pranuar dhe të paguara.

Rizik Raportimi për obligimet të cilat ende janë në afatin e lejuar ligjor, rritë rrezikun që komuna të jep informata të gabuara menaxhmentit, ndërsa, paraqitja e obligimeve në shumë më të madhe se sa që është real, rritë rrezikun e pagesës pa obligim. Paraqitja e obligimeve edhe në kuadër të obligimeve potenciale, sjellë deri te paraqitja e të dhënave të pasakta në PFV. Po ashtu është krijuar rrezik nga humbja e parasë publike, përkatësisht, që faturat e caktuara të paguhen disa herë.

Rekomandimi A8 Kryetari, duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshëm të kësaj fushe, dhe të bëjë ndarje më të mirë të detyrave ndërmjet të punësuarve, në mënyrë që të vendoset një sistem më efikas i evidentimit të faturave të pranuar dhe të paguara, dhe të cilat do të rezultojnë me informata më të sakta për gjendjen e llogarive të papaguara dhe pagimin më të rregullt të borxheve.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimit të rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve aponënkaptujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Menaxhimi me aktivitetet operative dhe financiare ende mbetet sfidë për komunën dhe ende mbeten fusha ku ka nevojë për veprime të rëndësishme. Përgjigjet efikase për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm, zhvillimi ndaj procesit të menaxhimit të rreziqeve, menaxhimi me procesin e prokurimit dhe pasurisë komunale, si dhe zbatimi i rekomandimeve të auditorit të brendshëm, janë disa nga fushat ku komuna ka nevojë që tu jep prioritet, sa i përket menaxhimit më efektiv.

Komuna nuk ka plan strategjik dhe nuk bënë analizimin për matjen e rezultateve të arritura të objektivave të caktuara në Strategjinë Zhvillimore të Komunës. Po ashtu, Komuna ka Plan të Përbashkët Komunal të zhvillimit me Komunën e Klllokotit (Viti/Klllokot 2010 - 2020).

Komuna ka arritur që ta plotësojë kërkesën e MF-së për dorëzimin e pyetësorit për vet-vlerësim, mirëpo, në aspektin e menaxhimit të rreziqeve, Komuna ende nuk ka arritur që ta përgatisë raportin rreth reagimeve në identifikimin e rreziqeve.

Njëri nga elementet kyç të menaxhimit efektiv është zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditorët e jashtëm. Përgjigja efektive për zbatimin e rekomandimeve nuk është e kënaqshme. Ky kapitull është shqyrtuar më në detaje tek kapitulli "Progresi në zbatimin e rekomandimeve".

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Në bazë të Ligjit nr. 02/L-74 për Auditimin e Brendshëm, çdo Organizatë Buxhetore duhet ta themelojë Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB) dhe të sigurojë që veprimtaria, të dhënat dhe sistemet e saja të menaxhimit dhe kontrollit i nënshtrohen së paku një herë në vit një Auditimi gjithëpërfshirës të brendshëm. Sistemi i duhur i auditimit të brendshëm i ndihmon menaxhmentit në identifikimin e dobësive në menaxhimin financiar dhe kontrollin e komunës. Kjo i shton vlerë parasë së shpenzuar dhe kontribuon në plotësimin e objektivave dhe përmirësimin e shërbimeve të cilat i ofron komuna.

Rekomandimet

Çështja C3 – Mos zbatimi i rekomandimeve nga auditori i brendshëm

Gjetja Numri i auditimeve të planifikuara nga ana e NjAB për 2018 ishte 7, ndërsa deri në fund të vitit ishin kryer 6 auditime. Nga gjithsej 25 rekomandime, vetëm 8 janë zbatuar në tërësi, 10 janë në proces të zbatimit, ndërsa 7 nuk janë zbatuar. Rekomandimet e dhëna kryesisht kanë mbuluar vitin e kaluar, deri në tremujorin e tretë të vitit aktual. Këto rezultate tregojnë mosgatishmërinë e menaxhmentit që ti shfrytëzojnë benefitet nga auditori i brendshëm dhe sigurinë gjatë punës së kontrolleve të brendshme.

Rreziku Mos zbatimi i rekomandimeve nga menaxhmenti dhe angazhim jo i mjaftueshëm i AB në këtë kuptim, e zvogëlon efikasitetin e kontrolleve të brendshme dhe përsëritjen e dobësive të identifikuara.

Rekomandimi C3 Kryetari duhet të sigurojë që fushëveprimi i NjAB të përfshinë sa më shumë që është e mundur, periudhën aktuale me ndihmën e aktiviteteve operative rrjedhëse. Njëkohësisht, duhet të ketë një fokus më të madh i menaxhmentit në adresimin e rekomandimeve dhe punës më aktive të AB në plotësimin e këtij objekti.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Shqyrtimi ynë i kontrolleve të menaxhmentit ka treguar raportim të dobët financiar të menaxhmentit të lartë për shpenzimet, si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Insistimi në vendosjen e përgjegjësisë për veprim apo mosveprim të mirë, nga e cila vjen deri tek akuzimi kundër Vetëqeverisjes Lokale duhet të jetë përgjegjësi e menaxhmentit. Për momentin, raportimi jo transparent dhe i pamjaftueshëm i parandalon të gjitha palët e interesit, përfshirë edhe shoqërinë civile, mediat dhe Kuvendin Lokal, por edhe Kryetarin që me kohë të reagojnë në këto situata, ku pasoja e fundit është dëmtimi i buxhetit të qytetarëve.

Duke pasur parasysh që Komuna ka probleme me saktësisë së listës së pasurive, çështja e cila gjithmonë ishte e iniciuar në raportet e auditimit të jashtëm, Kuvendi duhet që ti kushtojë rëndësi të veçantë raportit të pasurisë.

Çështje e rëndësishme është edhe mos raportimi në baza javore apo mujore tek Kryetari i Komunës dhe ndarja e përgjegjësive të personelit, ku një Zyrtar është përgjegjës për më shumë se një detyrë, ndërsa kjo ndodh për shkak të mungesës së personelit.

Rekomandimet

Çështja B6 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura Si rezultat i funksionimit jo të rregullt të kontrollit të menaxhimit, një sasi e konsiderueshme e shpenzimeve nga ana e zbatimit të vendimeve të organeve gjyqësore, të cilat kanë shkaktuar shpenzime shtesë në buxhetin e komunës dhe kanë rrezikuar krijimin e projekteve tjera të planifikuara, për shkak të tërheqjes së drejtpërdrejtë nga Thesari nëpër kategori të ndryshme.

Si pasojë e mosfunksionimit të kontrolleve të menaxhmentit, menaxhimit jo adekuat në pranimet dhe përcjelljen e llogarive, ka bërë që obligimi të mos jetë i shpërfaqur në vlerë të saktë në PFV. Dobësitë menaxheriale janë të vërejtura në fushën e subvencioneve, ku kontrollet nuk kanë vepruar mjaftueshëm në mënyrë që të shpërndaheshin dhe raportoheshin shpenzimet për këtë kategori. Të arkëtueshmet janë rritur dhe nuk janë ndërmarrë masa të veçanta për arkëtimin tyre. Po ashtu, objektet me qira ende shfrytëzohen në kundërshtim me ligjin. Nga ana tjetër, pasuria nuk ka pasqyruar situatën e saktë.

Menaxhmenti nuk ka raporte të rregullta për aktivitetet operative dhe analizën detaje të performancës së buxhetit. Komuna e ka regjistrin e rreziqeve, megjithatë, mungon pronësia mbi këto rreziqe dhe mekanizmat për përcjellje dhe raportim të Zyrtarit Kryesor Administrativ.

Rreziku Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i dobët, reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin buxhetor si dhe në reduktimin e mundësisë që menaxhmenti të reagojë ndaj sfidave financiare me kohë. Kjo po ashtu zvogëlon efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrezikun për shpenzime jo të rregullta. E gjithë kjo mund të rezultojë edhe në ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi B6 Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, plani i prokurimit, duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, të përcaktohet pronësia mbi rreziqet e identifikuara të individëve të caktuar, apo Bordit për menaxhimin e rreziqeve, të cilit do të raportojnë tek Zyrtari Kryesor Administrativ, në lidhje me rreziqet, përfshirë edhe auditimet e rregullta (tremujore) në mënyrë që të vërtetohet nëse janë ndërmarrë masat ashtu siç ishin planifikuar.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 për Komunën e Vitisë ka rezultuar me 16 rekomandime. Komuna e ka përgatitur një Plan Veprimi, ku formalisht paraqitet mënyrën se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në përfundim të periudhës së auditimit tonë, u zbatua vetëm gjashtë (6) rekomandime, një (1) është mbyllur, tri (3) ishin në proces ndërsa gjashtë (6) ende nuk ishin zbatuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë përgjegjësi më të madhe në kryerjen e detyrimeve me kohë në drejtim të operatorëve, si dhe që gjatë planifikimit të buxhetit duhet ta bëjë vlerësimin e shumave të mundshme të rrjedhës së parasë së gatshme nga kontestet gjyqësore dhe që ato të paguhen në kuadër të buxhetit vjetor, në mënyrë që të shmanget paraqitja e gabuar dhe të mos rrezikohet implementimi i shpenzimeve tjera të planifikuara.	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshëm ende.	Rekomandim i pa zbatuar.
2	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se dhënia e pronës komunale në shfrytëzim bëhet sipas procedurave të parapara ligjore dhe vendimeve të Kuvendit Komunal.	Komuna nuk ka ndërmarr aktivitetet e nevojshme për ndryshimin e gjendjes.	Rekomandimi i pa zbatuar.
3	Paga dhe kompensimet	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve gjatë përzgjedhjes së personelit edukativo - arsimor, me çka Komisioni për vlerësim pas procesit të vlerësimit ti rekomandoj DKA-së kandidatin e suksesshëm me vlerat maksimale në vlerësim, ndërsa tjetri ta nënshkruajë kontra tënë bazë të këtij rekomandimi.	Nuk kemi identifikua gjetje në këtë fushë.	Rekomandimi i zbatuar.
4	Mallra dhe shërbime, si dhe shërbime komunale	Kryetari duhet të sigurojë se marrëveshjet për shërbime të veçanta lidhen pas kryerjes së proceduarve të thjeshtëzuara të punësimit, përmes konkursit publik dhe vetëm në rast të kërkesave specifike për punë, dhe jo për pozicionet e rregullta.	Komuna nuk ka ndërmarr veprime, situata është e njëjtë edhe këtë vit.	Rekomandimi i pa zbatuar.
5	Mallra dhe shërbime, si dhe shërbime komunale	Kryetari duhet ta sigurojë fillimin e hershëm të procedurave të prokurimit për marrëveshjet për të cilat pritet të skadojnë, përlllogaritja e periudhës së ankesës apo barrierave potenciale, në mënyrë që kontrata të mbyllet para skadimit të kontratës aktuale.	Nuk kemi identifikuar ndonjë situatë të ngjashëm.	Rekomandimi i zbatuar.
6	Subvencionet dhe transferet	Kryetari të siguroj, forcimin e kontrolleve në fushën e dhënies dhe monitorimit të subvencioneve, me ç'rast fillimisht nënshkruhet një marrëveshje ku pala përfituese dakordohet lidhur me detyrimet e saj, e në anën tjetër sigurohen dëshmitë e mjaftueshme për shpenzimin e këtyre mjeteve, në mënyrë që ato të arrijnë qëllimin e synuar.	Komuna prapë ka treguar dobësi në zbatimin e proceduarve për ndarje të	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.

			subvencione ve.	
7	Investimet kapitale	Kryetari duhet që, në mënyrë që të sigurohet se projektet ende bashkë financohen, komuna ta ndërmerret përgjegjësinë në pajtim me dispozitat ligjore dhe rol aktiv në zbatimin dhe mbikëqyrjen e këtyre projekteve. Në të njëjtën kohë, në mënyrë që të sigurohet që pagesat të kryhen në lidhje me këto kontrata vetëm pas pranimit të raportit për punë, në bazë të ligjeve relevante, e jo në formë të pagesës paraprake.	Nuk kemi identifikuar ndonjë situatë të ngjashme.	Rekomandim i zbatuar.
8	Investimet kapitale	Kryetari duhet që të sigurohet që fillimisht të ndërmerret vlerësimi i duhur i planifikimit të buxhetit për projektet e planifikuara, ndërsa nënshkrimi i kontratave nuk i tejkalon mjetet e parapara për zbatimin e tyre.	Nuk kemi identifikuar ndonjë situatë të ngjashme.	Rekomandim i zbatuar.
9	Investimet kapitale	Kryetari, të siguroj se projektet janë pajisur me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kërkesat e ligjit të ndërtimit, me ç'rast fillimisht sigurohet leja ndërtimore, mbikëqyrja inspektive gjatë ekzekutimit dhe në fund të projektit të sigurohet leja e përdorimit.	Kemi identifikuar gjetje të ngjashme.	Rekomandim i pa zbatuar.
10	Investimet kapitale	Kryetari duhet të që të sigurohet që të gjithë ofertuesit me kohë të jenë të njoftuar për rezultatin e procesit tenderues, në pajtim me kërkesat e LPP-në.	Nuk kemi identifikuar ndonjë situatë të ngjashme.	Rekomandim i zbatuar.
11	Pasuria kapitale dhe jo kapitale	Kryetari duhet të siguroj forcimin e kontrollit të menaxhimit të pronës, në atë mënyrë, që të sigurohet që do të ndërmerren hapat konkret për ofrimin e dokumentacionit burimor nga MASHTOi, si dhe regjistrimi i pasurisë nga MAPL-ja, në regjistrat e pasurisë.	Nuk kemi identifikuar ndonjë situatë të ngjashme.	Rekomandim i pa zbatuar.
12	Pasuria kapitale dhe jo kapitale	Kryetari të siguroj se procesi i inventarizimit përfshin gjithë pasurinë komunale dhe pas kryerjes së këtij procesi, gjendja e inventarizuar krahasohet me regjistrin e përgjithshëm të pasurive, në mënyrë që diferencat e mundshme identifikohen dhe më pas pasqyrohen në regjistrat e pasurive.	Komuna nuk ka ndërmarr aktivitete për ndryshimin e gjendjes për regjistrimin e pasurisë.	Rekomandim i zbatuar.
13	Të arkëtueshmet	Kryetari duhet që, për tu siguruar bashkëpunimi më i madh ndërmjet Departamentit për harmonizimin e të dhënave për të arkëtueshmet, në mënyrë që të paraqiten drejt dhe në plotësi në FSB. Po ashtu, Kryetari i komunës duhet ta fillojë procedurën e rishqyrtimit, me çka të gjitha	Ne kemi identifikuar situatë të ngjashme pasi komuna nuk ka	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.

		Ilogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave të rëndësishme, mundësive reale për pagesë dhe zbatimit të masave ligjore për mbledhjen e tyre.	aplikuar aktivitete shtesë as këtë vit.	
14	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Kryetari duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, në mënyrë të vazhdueshme përcjell dhe raportin në baza të rregullta mujore apo tremujore, në kuptimin e progresit të arritur në atë kuptim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, duhet të shqyrtohen në afat të shkurt nga ana e Kryetarit, dhe të ndërmerren masat proaktive kundrejt pengesave të cilat janë shfaqur gjatë zbatimit.	Edhe këtë vit përkundër përgatitjes së planit për zbatim të rekomandimeve problemet vazhdojnë të jenë evidente.	Rekomandim i mbyllur i pa zbatuar.
15	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë se, në mënyrë që NJAB të përfshinë sa më shumë që është e mundur, periudhën aktuale me ndihmën e aktiviteteve operative rrjedhëse. Njëkohësisht, duhet të ketë një fokus më të madh i menaxhmentit në adresimin e rekomandimeve dhe punës më aktive të AB në plotësimin e këtij objekti.	KA tani është funksional mirëpo rekomandimet e NJAB nuk implementim ende.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
16	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, plani i prokurimit, duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, të përcaktohet pronësia mbi rreziqet e identifikuarat të individëve të caktuar, apo Bordit për menaxhimin e rreziqeve, të cilit do të raportojnë tek Zyrtari Kryesor Administrativ, në lidhje me rreziqet, përfshirë edhe auditimet e rregullta (tremujore) në mënyrë që të vërtetohet nëse janë ndërmarrë masat ashtu siç ishin planifikuar.	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme ende.	Rekomandim i pa zbatuar.
.Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1.	Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë se plani i përpilimit të PFV-së për vitin 2019 i adreson të gjitha çështjet të cilat janë cekur në lidhje me pajtueshmërinë e PFV-të, që është bërë analiza për përcaktimin e arsyeve për prezantimin jo të plotë të detyrimeve në PFV-të dhe të sigurojë se janë vendosur proceset efektive për një shpallje të drejtë në të ardhmen.		

2	Keq-klasifikim i shpenzimeve si rezultat i pagesave të drejtpërdrejta nga Thesari	Kryetari duhet të sigurojë përgjegjësi më të madhe në kryerjen e detyrimeve me kohë ndaj operatorëve, si dhe që gjatë planifikimit të buxhetit duhet ta bëjë vlerësimin e shumave të mundshme të rrjedhës së parasë së gatshme nga kontestet gjyqësore dhe që ato të paguhen në kuadër të buxhetit vjetor, në mënyrë që të shmanget paraqitja e gabuar dhe të mos rrezikohet zbatimi i shpenzimeve tjera të planifikuara.
3	Të hyrat-Dhënia me qira e pronës komunale pa iu nënshtruar procedurave të duhura	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se dhënia e pronës komunale në shfrytëzim të kryhet sipas procedurave të parapara ligjore dhe vendimeve të Kuvendit Komunal.
4	Mangësi në vendimin për shfrytëzimin e pronave	Kryetari duhet të sigurojë një kontroll më të lart në Drejtorinë për Shërbime Publike, në mënyrë që Rregullorja e brendshme për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha të zbatohet në tërësi dhe vendimet të jen të qarta dhe të sakta.
5	Pagat-Koeficiente të gabuara për përlllogaritjen e pagave në arsim	Komuna duhet ta bëjë pagesën retroaktive për pagesën e kompensimit të shumave të paguara më pak, për dy zyrtaret e cekura, si dhe me ashpërsimin e masave të kontrollit të brendshëm ta parandalojë përsëritjen e lëshimeve të ngjashme në të ardhmen.
6	Pagat - Parregullsi në shkolla për aftësimin profesionale	Kryetari i Komunës duhet që ti përcaktojë përgjegjësitë e atyre të cilët me veprime të veta kanë sjellë komunën në këtë gjendje të pafavorshme, dhe të ndërmer masat e përshtatshme në pajtim me ligjin. Të forcojë kontrollet e brendshme, në mënyrë që në të ardhmen të gjitha aktivitetet në lidhje me organizimin, funksionimin dhe financimin e shkollës për të rriturit të përshtaten në plotësi me Ligjet dhe Udhëzimet Administrative të MASHT-it.
7	Mallrat-Marrëveshjet për shërbime të veçanta pa procedura	Kryetari duhet të siguroj se marrëveshjet për shërbime të veçanta të lidhen pas zbatimit të procedurave të thjeshtëzuara të punësimit, përmes konkursit publik dhe vetëm në rastet e kërkesave specifike për punë, dhe jo për pozita të rregullta.
8	Mallrat -Vonesa në nënshkrimin e deklaratës në betim	Kryetarit të sigurohet se kontrollet e vendosura janë duke funksionuar dhe dëshmitë për funksionin të këtyre kontrolleve të plotësohen sipas afateve të parapara me rregulla.

9	Mallrat - Mangësi në procesimin e pagesave	Kryeri duhet të sigurohet se furnizimit i paraprin urdhëresa për blerje e cila është e mbuluar me zotim të mjaftueshme të mjeteve, apo mjetet të sigurohen para se të hyhet në obligim kontraktuale.
10	Subvencionet- Mosrespektimi i Rregullores së brendshme dhe Ligjit në fuqi	Kryetari i komunës duhet të sigurojë të gjitha masat në mënyrë që ta forcojë kontrollin e brendshëm të tërë procesit të ndarjes së subvencioneve, duke filluar nga Thirrja Publike, përmes respektimit të Rregullores gjatë aplikimit, emërimit dhe punës së Komisionit, e deri te raportimit, e gjithë kjo me qëllim që subvencionet e ndara ta arrijnë qëllimin e tyre.
11	Subvencionet- Mosrespektim i marrëveshjes dhe pagesa të parregullta	Kryetarin e Komunës duhet të vërtetojë arsyet për mosrespektimin e marrëveshjeve të arritura, si dhe mos shpenzimin e mjeteve të destinuara për qëllime për të cilat ishin mbledhur nga participimi i qytetarve, dhe ta forcojë kontrollin e brendshëm në këtë fushë, në mënyrë që kjo të mos ndodhë në të ardhmen.
12	Investime kapitale- Mungesa e lejeve të ndërtimit, mbikëqyrjes inspektive dhe lejes së përdorimit	Kryetari, duhet të siguroj se projektet janë pajisur me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kërkesat e Ligjit të ndërtimit, me ç' rast fillimisht sigurohet leja ndërtimore, mbikëqyrja inspektive gjatë ekzekutimit dhe në fund të projektit edhe leja e përdorimit.
13	Pasuria-Dobësi në regjistrimin dhe menaxhimin me pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të menaxhimit të pasurisë, në këtë rast, në mënyrë që të sigurohet se po ndërmerren hapat konkret për ofrimin e dokumentacionit burimor nga MASHT-i dhe regjistrimit të pasurisë të financuara nga ana e MAPL-ja, në regjistrat e pasurisë së komunës.
14	LLA- Menaxhim jo i mirë i llogarive e të arkëtueshmeve	Kryetari duhet ta fillojë procesin e rishqyrtimit, ku do të analizoheshin të gjitha llogaritë, në kuptimin e vjetërsisë, shumave të rëndësishme, mundësive reale për pagesë dhe zbatimit të masave ligjore për mbledhjen e tyre.
15	Obligimet- Raportimi i gabuar dhe evidentimi joadekuat i detyrimeve	Kryetari, duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshëm të kësaj fushe, dhe të bëjë ndarje më të mirë të detyrave ndërmjet të punësuarve, në mënyrë që të vendoset një sistem më efikas i evidentimit të faturave të pranuar dhe të paguara, dhe të cilat do të rezultonin me informata më të sakta për gjendjen e llogarive të papaguara dhe pagimin më të rregullt të borxheve.

16	NJAB- Mos zbatimi i rekomandimeve nga auditori i brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë se, në mënyrë që NjAB të përfshinë sa më shumë që është e mundur, periudhën aktuale me ndihmën e aktiviteteve operative rrjedhëse. Njëkohësisht, duhet të ketë një fokus më të madh i menaxhmentit në adresimin e rekomandimeve dhe punës më aktive të AB në plotësimin e këtij objekti.
17	Raportimi- Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut	Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, plani i prokurimit, duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, të përcaktohet pronësia mbi rreziqet e identifikuar të individëve të caktuar, apo Bordit për menaxhimin e rreziqeve, të cilit do të raportojnë tek Zyrtari Kryesor Administrativ, në lidhje me rreziqet, përfshirë edhe auditimet e rregullta (tremujore) në mënyrë që të vërtetohet nëse janë ndërmarrë masat ashtu siç ishin planifikuar.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një

opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër e Konfirmimit

[



Komuna e Vitisë

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z.Sokol Haliti

Kryetar i Komunës,

Data: 06.Qershor.2019, Viti,